



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.56/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kushtrim Kadriu – Kryetar i Lëvizjes Qytetare “Vatra”, me seli në Gjiilan, e parashtruar kundër subjektit politik - Lëvizja Vetvendosje (LVV), kandidat i komunës së Gjiilanit (Alban Hyseni), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do mbahen në Republikën e Kosovës më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 26.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa e Kushtrim Kadriu – Kryetar i Lëvizjes Qytetare “Vatra”, me seli në Gjiilan, ZL.Anr.56/2025, e parashtruar kundër subjektit politik - Lëvizja Vetvendosje (LVV), kandidat i komunës së Gjiilanit (Alban Hyseni), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 24.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Kushtrim Kadriu – Kryetar i Lëvizjes Qytetare “Vatra”, me seli në Gjiilan, e dërguar përmes postës me datë 22.09.2025, në të cilën thekson se, zyrtari publik Alban Hyseni i cili aktualisht mban pozitën e Kryetarit të Komunës së Gjiilanit, i njëjti më veprimet e tij ka përdorur deklaratat fyese dhe denigruese gjatë një debati televiziv të trasmetuar publikisht, ku ndër të tjera ka deklaruar: Zgjedhja e Kushtrim Kadriut është fyerja më e madhe që i është bërë Gjiilanit, Kushtrim Kadriu nuk përfaqëson asnjë vlerë, as për Gjiilanin e as për Luginën.

Këto deklarata janë tërësisht fyese dhe shpifëse ndaj personit tim, si dhe përbëjnë nxitje të urrejtjes dhe intolerancës politike ndaj meje dhe subjektit që përfaqësoj Lëvizja Qytetare “Vatra”. Zgjedhjet Lokale të 12 Tetorit, unë nuk jam kandidat për kryetar të Kuvendit të Komunës së

Gjilanit, andaj përmendja ime në një debat mes kandidatëve është jo vetëm e panevojshme, por edhe me prapavijë dëmtuese ndaj imazhit tim personal dhe politik.

Me tutje në ankesë ka theksuar se, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur prova materiale si: video e Alban Hysenit, zyrtarit publik që aktualisht mban pozitën e Kryetarit të Komunës në Gjilan dhe njëkohësisht kandidat për kryetar të Komunës në Gjilan në kuadër të subjektit politik “Lëvizja Vetvendosje” (LVV).

Në përgjigjen në ankesë, nga subjektit politik “Lëvizja Vetvendosje”, kandidat i komunës së Gjilanit (Alban Hyseni), është theksuar se deklaratat e dhëna nga kandidati ynë përfaqësojnë shprehje të lirë të mendimit politik dhe kritikë në kuadër të fushatës zgjedhore. Sipas nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, kandidatët dhe subjektet politike kanë të drejtë të shprehin lirisht qëndimet e tyre politike me qëllim të informimit të votuesve dhe fitimit të përkrahjes së tyre. Me tutje thekson se fjalë e përdorur nga z. Hyseni është kritikë politike, pa asnjë element të urrejtjes, intolerancës apo diskriminimit, dhe si e tillë hyn në kuadrin e diskursit të lejuar zgjedhor, duke i propozuar PZAP-së të refuzojë si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës ka gjetur se ankesa e parashtruar nga “Kushtrim Kadriu – Kryetar i Lëvizjes Qytetare “Vatra” kundër subjektit politik - Lëvizja Vetvendosje (LVV), kryetari i komunës së Gjilanit (kandidatit Alban Hyseni), është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.2. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”.* Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, me të cilin parashihet “Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme.” Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pasafatshme, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në youtube shihet se kandidati nga subjektit politik - Lëvizja Vetvendosje (LVV), kandidat i komunës së Gjilanit (Alban Hyseni)”, ka qenë në televizion me datë 16 Shtator 2025, ndërsa me datë 22.09.2025, ankesën ankuesi e ka paraqitur përmes postës, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit është paraqitur pas afatit ligjor prej 48 orësh.

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, parashihet që: “ *Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara*, ndërsa nën paragrafi 5.5 parasheh që: “*për shkeljet e pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*”. Pra, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se, ankesa është parashtruar, pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, ngjarja ka ndodhur me datë 16.09.2025, ndërsa ankesa është dorëzuar në postë më datë 22.09.2025, që do të thotë se njëjta është paraqitur pas afatit ligjor.

Paneli gjeti se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor, dhe duke u bazuar në nenin 118 paragraf 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.56/2025 datë 26.09.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi